

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P.Nr.504/2007

Data: 12 Shkurt 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga:

- 1) Gjykatësi i EULEX-it, Z. Francesco Florit, si Kryetar i Trupit Gjykues,
- 2) Gjykatësi i EULEX-it, Z. Ferdinando Buatier de Mongeot, si anëtar i trupit gjykues
- 3) Gjykatësi Kosovar, Z. Mehdi Dehari, si anëtar i trupit gjykues

Të ndihmuar nga i nënshkruari nëpunës i gjykatës, në çështjen penale kundër:

Jahja Lluka, i lindur në Pejë më 2 Mars 1952, emri i babait Mustafa Lluka, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës Ajshe Shala, Shqiptar i Kosovës, Biznesmen, me vendbanim në Rrugën Sefser, Veternik, Prishtinë, i martuar, baba i katër fëmijëve, Kolegji Universitar, gjendja ekonomike shumë e mirë;

I akuzuar sipas aktakuzës PP-KT Nr. 133-7/07 të ngritur më 20 Shtator 2007 nga Prokurori Publik Ndërkombëtar, për veprat penale: Deklaratë apo Raport i Rrejshëm – për llogarinë në Kasabank-, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafet (a) dhe (b), siç është ndryshuar me Rreguloren e UNMIK-ut 2006/53, nën pikën 1); dhe Deklaratë apo Raport i Rrejshëm – për llogarinë në Bankën Ekonomike-, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafet (a) dhe (b), siç është ndryshuar me Rreguloren e UNMIK-ut 2006/53, nën pikën 2); Pranimi i Paligjshëm i Kontributit, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, seksioni 10.8, siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, nën pikën 3);

Milazim Abazi, i lindur në fshatin Perpellac, Podujevë, më 25 Shkurt 1955, emri i babait Bajram Abazi, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës Naile Dauti, Shqiptar Kosovar, Ekonomist, me vendbanim në rrugën Sylejman Vokshi, Hyrja B, Nr. 11 në Prishtinë, i martuar, baba i një vajze, ka diplomuar nga universiteti, gjendja ekonomike e mirë, numri i letërnjoftimit 1015354760;

Hashim Sejdiu, i lindur në Dardanic, më 17 Mars 1977, emri i babait Enver Sejdiu, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës Vase Krasniqi, Shqiptar Kosovar, ekonomist i diplomuar, ish menaxher i departamentit të bizneseve të vogla dhe menaxher i degës së Prishtinës së Kasabankës, me vendbanim në Ulpianë, Juprogram, E19, Prishtinë, i pamartuar, nuk ka fëmijë, ka diplomuar në fakultetin ekonomik, e gjendjes së mesme ekonomike;

Të dy të akuzuar, sipas aktakuzës Nr. 133-7/07 të ngritur më 20 Shtator 2007 nga Prokurori Publik Ndërkombëtar, për veprën penale të Mosraportimit të Transaksioneve,

në Bashkëkryerje, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 të datës 5 Shkurt 2004, neni 10.6, paragrafi (b) mbi pengimin e larjes të parave dhe veprave të ngjashme penale, siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe Nenin 23 të KPPK, nën pikën 4);

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më 10 Dhjetor 2009, 18, 20, 26, 28 Janar dhe 9 Shkurt 2010, në prani të Prokurorit Special Nazmi Mustafi, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, Ramë Gashi dhe Arianit Koci për Jahja Llukën, Hamit Gashi dhe Burim Xhemajli për Milazim Abazin, Bajram Tmava për Hashim Sejdiun;

pas shqyrtimit të mbajtur më 11 Shkurt 2010, në bazë të nenit 391 (1) dhe nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari Jahja Lluca shpallet:

Fajtor për veprën penale të Deklaratës ose Raportit të Rrejshëm sa i përket llogarisë në Kasabank, siç përshkruhet më poshtë

AKUZA 1

LLUKA

Deklarata ose Raporti i Rrejshëm, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafet (a) dhe (b), siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.

Që në mes ose rreth 19 Gushtit 2005 dhe duke vazhduar deri më dhe duke përfshirë edhe 25 Janarin 2007 ose ditët rreth kësaj date, në Prishtinë, Jahja Lluca, bashkëthemeluesi dhe përfaqësuesi i autorizuar i Organizatës Joqeveritare ("OJQ") Komiteti për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt ("Fondi"), në dhënien e informatave ose në përgatitjen e raporteve, certifikatave ose deklaratave siç parashihet me nenet 3.1 deri në dhe duke përfshirë 3.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 në lidhje me bërjen e depozitimeve të valutave në llogarinë e Fondit në Kasabank, ka bërë me dashje deklaratatë materialisht të rrejshme ose ka lënë jashtë me dashje zbulimin e informatave materiale, ose ka bërë ose përdorur ose shkaktuar bërjen ose përdorimin e dokumenteve duke ditur që dokumentet përfshijnë deklaratatë ose hyrje materialisht të rrejshme, lënie jashtë, ose gabime, domethënë; kur ka bërë depozitime të valutave në shuma përtej 10.000 Euro në të njëjtën ditë në llogarinë KSB të Fondit, i ka ndarë dhe strukturuar depozitimet në transaksione të shumëfishta në shuma më të vogla se 10.000 Euro dhe në emra të individëve të tjerë të shumëfishtë, duke kompletuar dhe duke shkaktuar kompletimin e dokumenteve të depozitimit që në mënyrë të rrejshme kanë reflektuar burimin dhe shumat e përfshira, siç është specifikuar më plotësisht më poshtë.

Fajtor për veprën penale të Deklaratës ose Raportit të Rrejshëm sa i përket llogarisë në Bankën Ekonomike, siç përshkruhet më poshtë;

AKUZA 2

LLUKA

Deklarata ose Raporti i Rrejshëm, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafet (a) dhe (b), siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.

Që në mes ose rreth 07 Shtatorit 2005 dhe duke vazhduar deri më dhe duke përfshirë edhe 25 Janarin 2007ose ditët rreth kësaj date, në Prishtinë, Jahja Lluka, bashkëthemeluesi dhe përfaqësuesi i autorizuar i Organizatës Joqeveritare ("OJQ") Komiteti për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt ("Fondi"), në dhënien e informatave ose në përgatitjen e raporteve, certifikatave ose deklaratave siç parashihet me nenet 3.1 deri në dhe duke përfshirë 3.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 në lidhje me bërjen e depozitimeve të valutave në llogarinë e Fondit në Kasabank, ka bërë me dashje deklaratat materialisht të rrejshme ose ka lënë jashtë me dashje zbulimin e informatave materiale, ose ka bërë ose përdorur ose shkaktuar bërjen ose përdorimin e dokumenteve duke ditur që dokumentet përfshijnë deklaratat ose hyrje materialisht të rrejshme, lënie jashtë, ose gabime, domethënë; kur ka bërë depozitime të valutave në shuma përtej 10.000 Euro në një ditë të vetme në llogarinë KSB të Fondit, i ka ndarë dhe strukturuar depozitimet në transaksione të shumëfishta në shuma më të vogla se 10.000 Euro dhe në emra të individëve të tjerë të shumëfishtë, duke kompletuar dhe duke shkaktuar kompletimin e dokumenteve të depozitimit që në mënyrë të rrejshme kanë reflektuar burimin dhe shumat e përfshira, siç është specifikuar më plotësisht më poshtë.

Fajtor për veprën penale të Pranimit të Paligjshëm të Kontributit, siç përshkruhet më poshtë:

AKUZA 3

Pranimi i Paligjshëm i Kontributit, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.8, siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.

Që në mes ose rreth 19 Gushtit 2005 dhe duke vazhduar deri më dhe duke përfshirë edhe 25 Janarin 2007ose ditët rreth kësaj date, në Prishtinë dhe në vende tjera, Jahja Lluka, bashkëthemeluesi dhe përfaqësuesi i autorizuar i Organizatës Joqeveritare ("OJQ") Komiteti për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt ("Fondi"), me dashje ka pranuar në emër të OJQ Fondit një kontribut në valutë prej më tepër se 1.000 Euro në një ditë të vetme nga një burim i vetëm në shkelje të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 4.1, domethënë: në shumë raste në mes të datave të lartpërmendura, i pandehuri, i cili ka qenë individ që ka regjistruar Fondin si OJQ, ka hapur llogaritë bankare të Fondit në Kasabank dhe Bankën Ekonomike, dhe i cili ka pranuar dhe depozituar kontribute në kesh në emër të Fondit, ka pranuar kontribute në valutë nga individët dhe entitetet, si një burim i vetëm, prej më tepër se 1.000 Euro në një ditë të vetme, dhe pastaj i ka deponuar valutat e përmendura në llogaritë tjera të Fondit në shuma prej më tepër se 1.000 Euro në një ditë të vetme, siç është specifikuar më plotësisht më poshtë.

Në pajtim me nenin 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK),

I akuzuari **Milazim Abazi shpallet:**

I pafajshëm për veprën penale të Mosraportimit të Transaksioneve, në Bashkëkryerje, siç është përshkruar më poshtë:

AKUZA 4

ABAZI në bashkëkryerje me Sejdiun

Mosraportimi i Transaksioneve, në Bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 23 të KPPK dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.6, paragrafi (b), siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.

Që më ose rreth 19 Gushtit 2005 dhe duke vazhduar deri në dhe duke përfshirë 25 Janarin 2007 ose ditët rreth kësaj date, në Prishtinë, Milazim Abazi, Drejtori Gjeneral i Kasabank (KSB) dhe Hashim Sejdiu, Menaxher i Bizneseve të vogla të KSB dhe Menaxher i Degës së Prishtinës së KSB-së, në bashkëkryerje dhe duke vepruar si zyrtar dhe punonjës të KSB, me dashje kanë lënë anash përgatitjen e raportit, ose kanë shkaktuar mospërgatitjen e raportit, për Qendrën e Inteligjencës Financiare (QIF) për një veprim ose transaksion të dyshimtë ose transaksion në valutë prej 10.000 Euro ose më shumë, siç parashihet në nenin 3.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, domethënë: në disa raste në mes të datave të lartpërmendura, dhe me qëllim që të pengojë një funksion rregulator ose të zbatimit të ligjit, të pandehurit e përmendur me dashje kanë lënë anash përgatitjen, ose shkaktimin e përgatitjes së raportit drejtuar QIF, për transaksione të dyshimta ose transaksione të shumëfishta në një ditë të vetme për të cilat ata kanë pasur ose është dashtë të kenë njohuri, nga ana ose në emër të një personi ose entiteti, në shumë prej më shumë se 10.000 Euro, depozitimet e përmendura të gjitha janë bërë në të njëjtën kohë nga i pandehuri Jahja Lluca në llogarinë KSB të Komitetit për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt (Fondi i Mbrojtjes për Ramush Haradinajn) (Fondi), për të cilat ai i ka ndarë në depozitime ndaras prej 9.000 Euro secila, ose ndonjë shumë tjetër nën 10.000 Euro, dhe në emër të tjerëve.

I akuzuari **Hashim Sejdiu shpallet**

I pafajshëm për veprën penale të Mosraportimit të Transaksioneve, në Bashkëkryerje, siç përshkruhet më poshtë:

AKUZA 4

ABAZI DHE SEJDIU

Mosraportimi i Transaksioneve, në Bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 23 të KPPK dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.6, paragrafi (b), siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.

Që më ose rreth 19 Gushtit 2005 dhe duke vazhduar deri në dhe duke përfshirë 25 Janarin 2007 ose ditët rreth kësaj date, në Prishtinë, Milazim Abazi, Drejtori Gjeneral i Kasabank (KSB) dhe Hashim Sejdiu, Menaxher i Bizneseve të vogla të KSB dhe Menaxher i Degës së Prishtinës së KSB-së, në bashkëkryerje dhe duke vepruar si zyrtar dhe punonjës të KSB, me dashje kanë lënë anash përgatitjen e raportit, ose kanë shkaktuar mospërgatitjen e raportit, për Qendrën e Inteligjencës Financiare (QIF) për një veprim ose transaksion të dyshimtë ose transaksion në valutë prej 10.000 Euro ose më shumë, siç parashihet në nenin 3.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, domethënë: në disa raste në mes të datave të lartpërmendura, dhe me qëllim që të pengojë një funksion rregullator ose të zbatimit të ligjit, të pandehurit e përmendur me dashje kanë lënë anash përgatitjen, ose shkaktimin e përgatitjes së raportit drejtuar QIF, për transaksione të dyshimta ose transaksione të shumëfishta në një ditë të vetme për të cilat ata kanë pasur ose është dashtë të kenë njohuri, nga ana ose në emër të një personi ose entiteti, në shumë prej më shumë se 10.000 Euro, depozitimet e përmendura të gjitha janë bërë në të njëjtën kohë nga i pandehuri Jahja Lluka në llogarinë KSB të Komitetit për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt (Fondi i Mbrojtjes për Ramush Haradinajn) (Fondi), për të cilat ai i ka ndarë në depozitime ndaras prej 9.000 Euro secila, ose ndonjë shumë tjetër nën 10.000 Euro, dhe në emër të tjerëve.

DËNIMI

Jahja Lluka

Sipas pikës 1) të aktakuzës, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5 siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe nenet 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës dënohet me 6 muaj dhe 6000 euro.

Sipas pikës 2) të aktakuzës, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5 siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe nenet 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës, dënohet me 2 muaj dhe 2000 Euro.

Sipas pikës 3) të aktakuzës, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, neni 10.8 siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe nenin 38 (burgimi) dhe (39) gjoba të Kodit Penal të Kosovës dënohet me 2 muaj dhe 2000 euro.

Në pajtim me Nenin 396 para. 5) KPPK dhe Nenin 71 KPK, dënimi unik përcaktohet të jetë 10 muaj burgim dhe gjobë prej 10.000,00 (dhjetë mijë) Euro.

Koha e kaluar në paraburgim nga i akuzuari do të llogaritet si pjesë e dënimit me burg në pajtim me Nenin 391 Paragrafi (1) Nënparagrafi 5 i KPPK.

Në pajtim me Nenin 43 KPK dënimi do të jetë me kusht.

SHPENZIMET

I akuzuari do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Gjykata do të lëshojë një shpenzim ndaras mbi shumën e shpenzimeve kur të dhënat e tilla të sigurohen në pajtim me Nenin 100 Paragrafi (2) i KPPK.

ARSYETIMI

1) Historia

Në Mars 2005, Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë (TPNIJ) ka ngritur aktakuzë kundër Ramush Haradinajt, ish kryeministër i Kosovës dhe kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Më vonë Komiteti për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt, prej këtu e më tej Fondi) është themeluar nga Jahja Lluca, Astrit Haraqia dhe Ethem Çeku si themelues. Me ose rreth 25 Marsit 2005, Jahja Lluca ka hapur llogari në Kasabank në emër të Fondit.

Statutin për Fondin e ka nënshkruar inter alia Jahja Lluca si themelues me ose 03 Maj 2005 dhe Aplikacioni për të regjistruar Fondin si Organizatë Jo-Qeveritare, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/22, ishte i datës 10 Maj 2005. Më 11 Maj 2005, Kasabank (KSB) i ka dhuruar Fondit si donacion 70.000 Euro. Më ose rreth 23 Majit 2005, aplikacioni i Fondit për status të OJQ-së është aprovuar nga Ministria e Shërbimeve Publike. Me ose rreth 24 Majit 2005 Ethem Çeku dhe Astrit Haraqija kanë lëshuar një dokument me shkrim në emër të Fondit i cili autorizon Jahja Llukën që të hap llogari në Raiffeisen Bank, ProCredit Bank dhe Bankën Ekonomike dhe të jetë nënshkruar në këto llogari. Më ose rreth 06 Prillit 2005, Jahja Lluca ka hapur llogari në Bankën Ekonomike (BE) në emër të Fondit.

2) Historia procedurale

Më 20 Shtator 2007, Prokurorja Ndërkombëtare Caroline H. Henneman ka ngritur aktakuzë kundër tre të akuzuarve për akuzat e lartpërmendura. Më 8 Nëntor 2007 kryetari i trupit gjykues ka konfirmuar aktakuzën siç është parashtruar me vendimin e konfirmuar në ankesë më 14 Prill 2008.

Më 02 Shkurt 2009, në pajtim me vendimin JC/EJU/OPEJ/0215/mic/09, të lëshuar nga Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, Maria Giuliana Civinini, çështja kundër tre të pandehurve i është transferuar EULEX-it dhe më 24 Nëntor 2009, Kryetari i Trupit Gjykues, Francesco Florit, ka lëshuar një urdhër për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 10 Dhjetor 2009 kur, në prani të palëve dhe pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor, avokati mbrojtës Tmava ka kërkuar veçimin e procedurës kundër Z. Sejdiu dhe Z. Abazi, duke deklaruar që nuk ka asnjë lidhje kauzale në mes të dy sjelljeve të pretenduara dhe që veçimi i aktakuzës do të shpejtonte procedurën; trupi gjykues ka vendosur që procedura nuk do të veçohet sepse provat janë të përbashkëta për të tre të akuzuarit.

Më 11 Dhjetor 2009, avokati mbrojtës Tmava ka paraqitur një propozim për diskualifikimin e Gjykatësit Mehdi Dehari pasi që ai ka qenë i përfshirë në disa çështje të fazës paraprake në procedurën e njëjtë; Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Anton Nokaj, ka lëshuar një vendim më 14 Janar 2010 me të cilin ka refuzuar propozimin e avokatit Tmava si të pabazë.

Më 18 Janar 2010 shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar dhe, pas leximit të aktakuzës dëshmitarët: [REDAKTUAR] kanë dëshmuar përpara trupit gjykues dhe gjatë marrjes në pyetje të [REDAKTUAR] janë lexuar tri e-maila që ajo i ka dërguar dhe ato janë paraqitur si prova.

Më 20 Janar 2010, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me marrjen në pyetje të dëshmitarëve: [REDAKTUAR];

Më 26 Janar 2010, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me marrjen në pyetje të dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe dëshmitares [REDAKTUAR], dhe pastaj janë diskutuar propozimet e palëve mbi provat: prokurori ka propozuar leximin e deklaratave të 21 dëshmitarëve tashmë të intervistuar gjatë fazave paraprake, avokatët mbrojtës, pas konsultimit, unanimisht e kanë refuzuar propozimin e prokurorit dhe kanë propozuar thirrjen e 9-10 dëshmitarëve për të dëshmuar përpara trupit gjykues. Trupi gjykues, pas shqyrtimit, ka vendosur që asnjë nga dëshmitarët e propozuar nga palët nuk janë të nevojshëm, dhe trupi gjykues sipas detyrës zyrtare ka vendosur që të ftojë dëshmitaren [REDAKTUAR].

Më 28 Janar 2010, [REDAKTUAR] ka dëshmuar përpara trupit gjykues, dhe pas saj tre të pandehurit: Z. Lluka, Z. Abazi dhe Z. Sejdiu janë ftuar që të dëshmojnë; i pari dhe i dyti kanë dëshmuar gjerësisht përderisa Z. Sejdiu ka vendosur që të mbetet i heshtur. Në fund, trupi gjykues ka vendosur mbi pranueshmërinë e provave në forma dokumentesh, duke shpallur të pranueshme të gjitha dokumentet e listuara në aktakuzë.

Më 9 Shkurt 2010, trupi gjykues ka dëgjuar fjalët përfundimtare nga prokurori publik dhe avokatët mbrojtës, të akuzuarit nuk kanë dashtë ti shtojnë asgjë asaj që e kanë deklaruar avokatët e tyre.

Më 12 Shkurt 2010 trupi gjykues publikisht e ka shpallur aktgjykimin.

3) Ligji i aplikueshëm, kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues

Të pandehurit janë akuzuar për vepra të cilave i referohen rregulloret e UNMIK-ut kundër larjes të parave (Rregullorja nr. 2004/2 dhe ndryshimet vijuese).

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje: KPPK), Gjykatat e Qarkut do të kenë kompetencë që të gjykojnë në shkallë të parë veprat penale që dënohen me së paku pesë vjet ose me burgim afatgjatë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka kompetencë territoriale, pasi që aty kanë qenë degët e bankave ku janë kryer

veprat e pretenduara të deklarimit të rrejshëm dhe mosraportimit (të cilat janë ato më të rëndat).

Vepra penale bie nën sferën e nenit 3, para. 2 të Ligjit mbi Kompetencat (3-L053/2008), i cili cekë kompetencën primare të Gjykatësve të EULEX-it. Neni 3 para. 2 cekë që Gjykatësit e EULEX-it kanë kompetencë për fazën përkatëse të procedurës penale të hetuar ose të ndjekur penalisht nga PSRK-ja. Neni 5 para. 1 shkronja o) e ligjit mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës cekë që PSRK është kompetence për "Veprat penale të paraqitura në nenin 10 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut no. 2004/2 mbi Pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale". Një gjykatës Kosovar ka qenë anëtarë i trupit gjykues gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 4.7 të Ligjit mbi Kompetencat. Duhet shtuar që in limine litis palët nuk kanë pasur asgjë për të kundërshtuar sa i përket përbërjes së trupit gjykues.

4) I akuzuari Jahja Lluka

4.1) Sa i përket pikave 1 dhe 2 të aktakuzës

I pandehuri është akuzuar për deklaratë ose raport të rrejshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafet a) dhe b), duke iu referuar nenit 3.5 të rregullores së njëjtë të UNMIK-ut.

Normat e tilla janë pjesë e një grupi të madh të dispozitave që janë futur në legjislacionin e Kosovës me qëllim që ti binden praktikave më të mira që tani implementohen në nivelin ndërkombëtar (në pajtim me GAFI/FATF rekomandimet dhe me instrumentet kryesore ndërkombëtare mbi larjen e parave për të cilat është arritur marrëveshje në nivelin e OKB dhe KE).

Është e rëndësishme që këtu të ceket që sjellja që është kriminalizuar me normat e lartcituara nuk është në vetvete larje parash. Sjelljet (ose lëniet jashtë) të cilat dënohet kanë për qëllim parandalimin e kryerjes së larjes së parave, duke i kriminalizuar veprimet ose lëniet jashtë që do të parandalonin agjencitë e zbatimit të ligjit (në këtë rast: Qendrën e Inteligjencës Financiare) nga zbulimi që janë duke u ndërmarrë veprime të dyshimta që mund të kenë të bëjnë me larje parash.

Më saktësisht, Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2/2004 i obligon bankat që të verifikojnë shënimet personale të gjithë klientëve para...(d) Përfshirjes në një transaksion në para prej më shumë se 10.000 eurosh, transaksionet e shumta në para do të trajtohen si transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë udhëhequr nga një person apo në emër të një personi ose subjekti dhe shuma e përgjithshme për një ditë është më shumë se 10.000 euro.

Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2/2004 cekë që personi i angazhuar në transaksion sipas nenit 3.1 vërteton me shkrim në bankë ose në institucionin financiar, në formatin e përcaktuar nga BPK-ja se vepron:

(a) Në emër të tij ose të saj si pronar dhe përfitues i çfarëdo pasurie e cila i nënshtrohet transaksionit ose

(b) Si përfaqësues i autorizuar i një apo më shumë personave a subjekteve të identifikuar sipas neneve 3.3 ose 3.4, që ka marrë hapat e arsyeshëm për të verifikuar se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronar apo përfitues i çfarëdo pasurie, e cila i

nënshtrohet transaksionit, dhe beson në mirëbesim se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronar a përfitues i çfarëdo pasurie e cila i nënshtrohet transaksionit. Neni 3.5 i Rregullores së njëjtë të UNMIK-ut përcakton që çdo person i cili vepron si përfaqësues i autorizuar do të prezantojë dokumentet në pajtim me nenet 3.3 dhe 3.4 për vete dhe për personin ose subjektin që e ka autorizuar dhe do të sigurojë dokument me të cilin autorizohet ai ose ajo për udhëheqjen e transaksioneve në emër të personit a të subjektit të tillë.

Në fund, neni 10.5 parasheh sanksionet penale për disa nga sjelljet e lartpërmendura, duke cekur që kushdo që duke siguruar ndonjë informacion apo duke raportuar dhe duke bërë

certifikata ose deklaramë në pajtim me nenet prej 3.1 deri 3.5... të rregullores në fjalë, me dije (a) Bën çfarëdo deklarate materiale të rrejshme ose me qëllim nuk i zbulon informacion material ose

26

(b) Bën apo shfrytëzon çfarëdo dokumenti duke e ditur se dokumenti përmban deklaratë ose shënime të rrejshme materiale, mostregim material ose gabim material Konfiguracioni si më lart i kornizës legjislative e bën të qartë që krimi për të cilin akuzohet i pandehuri nuk kërkon që gjykata, me qëllim që të gjej kryerjen e krimit, të ketë provë që transaksionet i referohet të ardhurave nga krimi. Testi provues që gjykata është thirrur ta kryej nuk ka të bëjë me origjinën e ndaluar të pronës, por thjeshtë me përmbushjen e detyrave të raportimit/deklarimit që janë ilustruar më lart.

Në këtë rast, në fund të procedurës provuese ekzistojnë prova të plota që Jahja Lluka i ka shkelur dispozitat e cekura më lart, duke kryer kështu veprat penale të numëruara nën 1 dhe 2.

Provat e tilla janë siguruar së pari nga dokumentacioni masiv i konfiskuar nga hetuesit në Bankë, në banesën e Jahja Llukës dhe në zyret e OJQ-së e cila e drejtonte fondin për mbrojtjen e Ramush Haradinajt.

Së dyti, dosja e lëndës përmban deklaratat që i ka dhënë vet Jahja Lluka gjatë hetimeve, të cilat përmbajnë një numër deklaratash vet-akuzuese, me vlerë shumë të madhe provuese.

Në fund, gjatë shqyrtimit gjyqësor disa dëshmitarë kanë dhënë informata shtesë me relevancë provuese kundër Jahja Llukës.

Në veçanti, në fund të procedurës së provave këto në vijim mund të konsiderohen si të vërtetuara sa i përket pikës 1 të aktakuzës (Kasabank):

- më datat 19 Gusht, 5 Shtator, 6 Shtator, 24 Nëntor 2005, 10, 14 Shkurt dhe 20 Shkurt 2006 Jahja Lluka ka shkuar në degën ABC të Kasabankës. Në veçanti:
- më 19 Gusht 2005 ai i ka depozituar 45.000 në 5 transaksione të ndryshme nga 9.000 euro, duke i nënshkruar dy nga dëftesat e depozitimit;
- më 5 Shtator 2005 ai ka depozituar 203.000 në 22 transaksione të ndryshme nga 9.000 euro secili dhe 4 transaksione prej 5.000 euro secili, duke nënshkruar të gjitha dëftesat e depozitimit.
- Më 6 Shtator 2005 ai ka depozituar 209.000 në 21 transaksione të ndryshme prej 9.000 secili dhe 4 transaksione prej 5.000, duke nënshkruar shumicën e dëftesave të depozitimit me emrin e tij;
- Më 24 Nëntor 2005 ai ka depozituar 363.000 euro në kesh në 39 transaksione të ndryshme prej 9.000 secili dhe nga një transaksion prej 8.000 euro, 3.000 euro dhe 1.000. Një pjesë e dëftesave janë nënshkruar me nënshkrimin e njëjtë.

- Më 10 Shkurt 2006 ai ka depozituar 100.000 në kesh në llogarinë e fondit me 10 transaksione të ndryshme prej 9.000 euro secili në emër të Llukës dhe në emra të individëve tjerë.
- Më 14 Shkurt 2006 ai ka depozituar 243.000 në 27 transaksione të ndryshme prej 9.000 secili, duke nënshkruar shumicën e dëftesave me emrin e tij;
- Më 20 Shkurt 2006 ai ka depozituar 100.000 në kesh në 16 depozitime të strukturuar në shuma prej 5.000 deri në 9.000 euro të gjitha në emra të ndryshme, sipas udhëzimeve të tij, duke nënshkruar të gjitha dëftesat e depozitimit.
- Më 3 Nëntor 2006 Lluka ka depozituar 200.000 euro në 27 transaksione të ndryshme në shuma prej 4.000 deri në 9.700 euro në emra të ndryshëm, duke nënshkruar secilën prej dëftesave.

Si rezultat i të lartpërshkruarit modus operandi, shënimet bankare tregojnë që depozitarët kanë qenë personat që ai i ka emëruar, e jo ai vet. Rrethanat e lartpërmendura vërtetohen tërësisht edhe me dëftesat e depozitimit edhe me shënimet bankare nga dosja e lëndës, si dhe me deklaratat e qarta të dëshmitarëve [REDACTED] (arkëtare në Degën ABC), [REDACTED] (Menaxhere e Degës në Degën ABC), [REDACTED] (Zyrtare AML e Kasabank), si dhe me pranimet e të njëjtit Jahja Lluka përpara Prokurorit Publik dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në të vërtetë:

- Sipas arkëtareve së degës ABC të Kasabankës, [REDACTED] dhe [REDACTED], Z. Lluka në disa raste ka ardhur në bankë me thasë të mbushura me të holla kesh – me shuma totale të ndryshme por shumë më të larta se pragu prej 10.000 euro i caktuar me ligj-dhe me një listë të emrave që përmbante rreth 20/30 emra. Të hollat kesh pastaj janë ndarë në depozitime më të vogla se 10.000 euro dhe secili është depozituar nën emra ndryshe, përderisa vet Z. Lluka i ka nënshkruar dëftesat.
- Shënimet bankare tregojnë që secili prej depozitimeve të strukturuar është bërë nga persona të ndryshëm. Me fjalë tjera, depozituesit duket se janë personat emrat e të cilëve figurojnë në shënimet bankare¹;
- Pas kontrollimit të shënimeve bankare të shtypura në letër me dëftesat e depozitimeve të cilat janë në dosje të lëndës (të cilat kanë të bëjnë me transaksionet e njëjta të shënuara në shënime), është e mundur që të konstatohet që nënshkrimi në vet dëftesat e depozitimit në shumicën e rasteve ka qenë i Jahja Llukës². Në gati të gjitha dëftesat tjera të depozitimit, nënshkrimet e blloqeve të dëftesave që janë bërë në ditën e njëjtë janë nga edhe dy persona tjerë (të cilët kanë nënshkruar me emrat e tyre një numër depozitimesh kinse të bëra nga persona të ndryshëm)³. Sipas mendimit të trupit gjykues duhet arritur domosdoshmërisht përfundimin që Jahja Lluka, në rolin e tij të Përfaqësuesit të Autorizuar të “Fondit për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt” ka qenë në dijeni dhe

¹ Shih dokumentet që janë pjesë e dosjes së lëndës

² Ky është rasti, për shembull, me dëftesat bankare të 19 Gushtit 2005, 6 Shtatorit 2005, 5 Shtatorit 2005, 14 Shkurtit 2006, 20 Shkurtit 2006, 3 Nëntorit 2006, shumica prej të cilëve janë nënshkruar nga Jahja Lluka me vet nënshkrimin e tij, gjithashtu kur depozitimet duket që janë bërë në emër të disa personave tjerë.

³ Ky është rasti me dëftesat e depozitimit të 24 Nëntorit 2005

ka marrë pjesë gjithashtu në depozitimet e strukturuar në të cilat nënshkrimi në dëftesat e depozitimit duket se nuk është i tij. Kjo sepse:

- Mënyrat e ekzekutimit të depozitimeve të tilla të fundit kanë qenë saktësisht të njëjta me depozitimet në të cilat duket nënshkrimi i Jahja Llukës, duke shfaqur kështu një strategji të përbashkët pas të gjitha transaksioneve;
- Ekzistimi i një numri tepër të madh të donacioneve prej saktësisht 9.000 euro nuk shpjegohet në mënyrë të besueshme nga i pandehuri (sipas të cilit në shumë raste qytetarët kanë ardhur në zyrën e Shoqatës dhe i kanë sjell kontributet e tyre në kesh). Trupi gjykues është i mendimit që nuk është realisht e pranueshme që një numër aq tepër i madh i depozitimeve të barabarta mund të bëhet në realitet në mënyrë autonome në të njëjtën kornizë kohore nga individë të ndryshëm.
- Secili prej depozitimeve të strukturuar në fjalë ka ndodhur në një distancë kohore prej minutash (nëse jo sekondash) nga ai vijues. Kjo në mënyrë të dokumentuar konfirmon që gjithmonë ka qenë personi i njëjtë që kryente depozitimet, dhe jo persona të ndryshëm (sepse në të kundërtën, sipas asaj që është deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nga [REDAKTUAR], sistemi TI i Bankës do të kishte nevojë për më shumë kohë për të proceduar ndryshimin nga një klient në klientin tjetër);
- Arkëtarët e bankës të cilët janë ftuar që të dëshmojnë dhe të cilët i kanë pranuar depozitimet kanë deklaruar që në disa raste të hollat i ka sjellur në bankë i pandehuri Jahja Lluka, në një thes, i cili përmbante kesh të mbështjellur me faqe të gazetave; Jahja Lluka i ka prezantuar arkëtarëve një listë të emrave të personave të cilët kinse kanë kontribuar për "Fondin për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt" (pa prezantuar asnjë letër autorizimi, që do ta autorizonte atë të depozitonte këto të holla në llogarinë bankare në emër të tyre), së bashku me tërë shumën e të hollave. Pastaj ai i ka nënshkruar të gjitha dëftesat e depozitimit, një për secilin transaksion që është bërë⁴:

⁴ Shih, për shembull, deklaratat e dëshmitarës [REDAKTUAR], menaxhere e degës në Degën ABC në Kasabank, ku përshkruhen mënyrat e depozitimit nga ana e të pandehurit:

[REDAKTUAR]: Një herë në ditë deri në 200.000 euro. Ka pasur shuma të ndryshme të depozitimeve të parave por shuma më e madhe ka qenë 200.000 euro.

Prokurori Publik: Kur ai i ka pasur 200.000 euro me veti, a i ka depozituar të gjitha këto të holla ditën e njëjtë?

[REDAKTUAR]: Po.

Prokurori Publik: Ai e ka bërë të njëjtën gjë me raste tjera.

[REDAKTUAR]: Po.

Prokurori Publik: A të kujtohet se çfarë shuma të hollash i ka depozituar ai në rastet tjera në bankën tuaj?

[REDAKTUAR]: Shuma e hollave ka ndryshuar por përafërsisht 200.000 euro, ose 150.000 euro.

Prokurori Publik: Në emër të kujt i ka bërë ai depozitimet?

[REDAKTUAR]: Nuk më kujtohen emrat por kanë qenë persona individual.

Prokurori Publik: Si e kupton ti këtë?

- Në mënyrë të qartë, i pandehuri pranoi se (të paktën sa i përket pjesës më të madhe të transakcioneve të cekura më lart) burimi ishte një kontribut i vetëm prej 530.000 Euro, dhënë fondit nga huaja e Z. [REDAKTUAR] më 2 shtator 2005. Vlen të përmenden në mënyrë të zgjëruar deklaratat e dhëna nga i pandehuri duke marrë parasysh rolin e tyre shumë të rëndësishëm në zgjedhjen e kësaj lënde. Deklaratat në fjalë janë bërë para prokurorit publik më 17 prill 2007. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri është ballafaquar me rrethanat e njëjta dhe janë sjellur në pah edhe deklaratat e dhëna më parë⁵. Është e rëndësishme të vihet re se i pandehuri në mënyrë të qartë e pranoi se për të anashkaluar obligimin ligjor të raportimit të shumës prej 535.000 Euro Euro që i takonin Z. [REDAKTUAR], menaxhmenti i OJQ-së vendosi që të ndajë shumën në shumë deponime të veçanta prej më pak se 10.000 Euro, gjoja të donatorëve të shumtë dhe të ndryshëm, duke iu shmangur detyrimit të raportimit. E rëndësishme së veçanti, Z. Lluka shprehimisht pranoi të ketë qenë i vetëdijshëm mbi ekzistimin e dispozitës ligjore që parashohin raportimin e transakcioneve të tilla dhe prandaj, mënyra e tillë e të proceduarit “nuk ishte edhe aq e përshtatshme”.
- Është veçanërisht e rëndësishme të vihet re se një modus operandi identik veprimi është adoptuar nga Jahja Lluka me të gjitha deponimet e tjera për të cilat akuzohet sa u përket transakcioneve në Kasabankë dhe atyre në Bankën Ekonomike. Kjo rrethanë është indikator i qartë i ekzistimit të një veprimi të organizuar dhe të

⁵ Prokurori Publik: Jam i përqëndruar në këto 39 depozitime. A i keni takuar ju personalisht këta 39 persona dhe a i keni pranuar të hollat nga ata?

Jahja Lluka: Jo.

Prokurori Publik: A mund të na thoni se si përfunduat ju me të gjitha këto të holla të gatshme?

Jahja Lluka: Z. Ramush Haradinaj kërkoi të holla hua nga Z. [REDAKTUAR] dhe arritën një marrëveshje, sipas së cilës ai mund të marrë hua pesëqind e tridhjetë e pesë mijë euro. Pas arritjes së marrëveshjes, më informuan mua dhe Z. Haradinaj më autorizoi të pranoj këto të holla nga Z. [REDAKTUAR].

Prokurori Publik: Pyetja ime ka të bëjë me 39 emrat në listë. A thoni se Z. [REDAKTUAR] ka diçka të bëjë me këtë?

Jahja Lluka: Z. [REDAKTUAR] nuk deshi të njihej publikisht për këtë gjë. Prandaj, kërkua nga ca njerëz të bëjmë depozitimin në emrat e tyre.

Prokurori Publik: Për shembull, Enver Berisha depoziton nëntë mijë euro. Ju thoni se këto nëntë mijë euro të deponuara nga Enver Berisha janë në të vërtetë nga [REDAKTUAR]?

Jahja Lluka: E vërtetë.

Prokurori Publik: Ju thoni se të gjithë tridhjetë e nëntë persona pranuan të deponohen të hollat në emrat e tyre edhe pse nuk ishin të hollat e tyre? A po thoni kështu?

Jahja Lluka: Disa prej tyre ishin donatorë të vërtetë, por nuk më kujtohet se cilët ishin.

...

Prokurori Publik: A ju kujtohet pse vendosët që të depononi të holla në shumën prej nëntë mijë euro e jo në shumën prej njëmbëdhjetë apo dymbëdhjetë mijë euro?

Jahja Lluka: Për të mos kryer shkelje ligjore.

Prokurori Publik: Ju e keni kuptuar se ishte kundër ligjit të bëhet deponime me para të gatshme mbi shumën 10 mijë euro, apo jo?

Jahja Lluka: Nuk është kundër ligjit, por duhet të tregohet se nga vijnë të hollat ...

Prokurori Publik: A ju kujtohet se kush ju tha se të hollat duhet të jenë nën shumën dhjetë mijë euro?

Jahja Lluka: Jo.

....

Jahja Lluka: Gjetëm një mënyrë që nuk ishte edhe aq e përshtatshme. Por kështu ishte mënyra për të deponuar të hollat e personave që dëshironin të mbetnin anonimë dhe unë i thashë edhe Z. [REDAKTUAR] që për shkak se ishte shumë e madhe e të hollave, do të ishte më mirë që ai vetë t'i depononte këto.

standartizuar (duhet vënë re edhe se mënyra e tillë e të vepruarit ishte thjesht e nevojshme duke pasur parasysh shumat e mëdha të të hollave të gatshme, të nevojshme për të futur në llogaritë e OJQ-së në fjalë).

Rrethanat e përshkruara më lart e bëjnë të qartë se i pandehuri Jahja Lluka kreu veprat penale të parapara nën pikët 1 dhe 2, duke deponuar në mënyrë të artikuluar dhe të strukturuar shumat shumë më të mëdha se 10.000 Euro në një mori deponimesh prej më pak se 10.000 Euro.

Mendimi i Trupit Gjykses është se prania e elementit *mens rea* bëhet e qartë nga pranimi i njëjtë i të pandehurit. Ai deklaroi qartë se:

- ishte i vetëdijshëm mbi kërkesën ligjore për të raportuar transaksionet mbi 10.000 Euro.
- sajoi manovrën e deponimeve të strukturara në mënyrë specifike për t'u shmangur detyrimit ligjor të raportimit, me qëllim të "konfidencialitetit" për disa deponime që kalonin shumë prej 10.000 Euro.

Kjo e bën të qartë se i pandehuri ishte më se i vetëdijshëm mbi kërkesat ligjore dhe se ai në mënyrë dashëse veproi për t'u shmangur atyre.

4.2) Lidhur me pikën 3 të aktakuzës

Pjesa 4.1 e Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 53/2006 parasheh se "*Përpos asaj që është paraparë në nenin 4.3, OJQ-ja nuk do të pranojë contribute në para që tejkalojnë 1.000 euro nga një burim i vetëm brenda një dite*".

Neni pasues 10.8 i Rregullores së njëjtë parasheh se "*Kushdo që me dashje pranon ose paguan valutën në kundërshtim me nenet 4.1, 4.2, 5.1 ose 5.2 të kësaj rregulloreje, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy vjet dhe me gjobë deri në 5.000 euro ose me dyfishin e shumës së valutës së pranuar a të paguar, cilado prej tyre që është më e lartë*".

Jahja Lluka akuzohet me pranimin (gjatë periudhës kohore gusht 2005 dhe janar 2006) e donacioneve nga individë dhe subjekte në kundërshtim me dispozitat më lart.

Përfundimi i shqyrtimit kryesor dhe provat e gjendura në dosjen e lëndës sjellin në pah prova të plota të fajësisë së Jahja Llukës sa i përket kësaj pike të aktakuzës.

Në parim, korniza e provave që sjellë deri te ky përfundim është e njëjta që provon fajësinë e të pandehurit sa u përket dy veprave të para.

Ç'është e vërteta,

- Fillimisht, Jahja Lluka në mënyrë të qartë deklaroi se pranoi nga [REDAKTUAR] një hua të vetme në shumën prej €535.000 në katër këste. Kjo deklaratë është përsëritur para prokurorit publik dhe gjatë shqyrtimit kryesor. Pranimi i tillë mban rëndësinë e provave të pranimi të fajësisë. Siç u ilustrua më lart, pranimi i fajit të tillë konfirmohet fuqishëm nga provat dokumentuese (dokumente mbi deponimet dhe të dhënat bankare lidhur me deponimet e strukturuar me anë të së cilave Jahja Lluka solli në llogarinë bankare shumë dhënë hua Fondit për Mbrojtje). *Si e tillë*, kjo mjafton për të pohuar përgjegjësinë penale të Jahja Llukës për veprën e paraparë me Nenin 10.8.
- Përpos kësaj, në përpjekje për t'u mbrojtur nga akuzat nën pikët 1 dhe 2, Jahja Lluka eventualisht deklaroi se Fondi për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt pranoi huanë në shumën prej 535.000 Euro në katër këste nga një donator i vetëm (duke

kryer kështu në mënyrë automatike veprën penale të përshkruar nën pjesën 10.8 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2). Madje, ai pranoi se disa nga deponimet e tjera prej 9.000 Euro, që përfunduan në llogaritë e Fondit erdhën nga donacione të mëparshme (të shumës së njëjtë) nga qytetarë privatë të Kosovës. Është e rëndësishme të ceket se Jahja Lluka (apo vartësit e tij në emër të tij) kishte pranuar donacione të shumës së përgjithshme shumë më të madhe se huaja e dhënë nga Z. [REDAKTUAR] më lart. Kjo bëhet e qartë nga fakti se shumë më shumë se 535.000 Euro u deponuan në llogaritë bankare të Fondit (shuma e përgjithshme e të hollave ishte mbi 1,5 milion Euro) dhe se ka prova të dokumentuara (letër deponimi dhe të dhëna bankare) të deponimeve të shumëfishta në llogaritë bankare që gjithsej janë mbi 535.000 Euro. Pothuajse të gjitha deponimet e tilla u referohen donacioneve mbi 1.000 Euro secila, të cilat OJQ-ja pranoi nga donatorët. Kjo përbën prova mbi shkelje të mëtutjeshme të dispozitës penale të paraparë me Nenin 10.8 të Rregullores së UNMIK-ut 2/2004 shtuar pranimit të kontributit prej 535.000 Euro nga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. Elementi *mens rea* është i pranishëm sa i përket sjelljes së përshkruar nën pikët 1 dhe 2 si dhe asaj nën pikën 3.

Në çështjen aktuale, *res ipsa loquitur* mund të thuhet se për shkak se:

- Është dëshmuar se i pandehuri në mënyrë dashëse ka pranuar një sasi shumë të madhe të kontributeve nga disa donatorë,
- Shuma e pjesës së madhe dhënë Fondit tejkaloi pragun ligjor prej 1.000 Euro,
- Dispozitat ligjore që penalizojnë sjelljen prej pranimit të paligjshëm të kontributeve ishin aprovuar më shumë se një vit para se të ndodhnin episodet e para,
- Prapavija kulturore dhe profesionale e të pandehurit dhe fakti se kishte pozitën e përfaqësuesit ligjor të Fondit e bëjnë të pamundur mendimin se ai është futur në një situatë të falshme injorance mbi dispozitat ligjore që penalizojnë sjelljet e tij.

5) Të akuzuarit Milazim Abazi dhe Hashim Sejdiu

Milazim Abazi dhe Hashim Sejdiu në cilësinë e tyre si Drejtor i Përgjithshëm dhe Menagjer Dege në KSB janë të ngarkuar me shkeljen e pjesës 10.6 paragrafi b) i Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 në bashkë-kryerje sa i përket Nenit 23, KPK.

Dispozita në fjalë parasheh *kushdo që me dashje b) Nuk raporton në pajtim me nenet 3.9, 3.11, 4.5, 5.4, 6.3, 6.7, 6.8 apo 7.2, kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në dy vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro. Nëse çfarëdo vepre penale e paraparë me këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues ose të zbatimit të ligjit, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro.* Në rastin specifik, pretendohet se të pandehurit me dashje dhe në bashkë-veprim nuk raportuan në QIF transaksionet e dyshimta të kryera nga i pandehuri Jahja Lluka.

Në pajtim me ligjin, elementet e veprës penale janë identifikuar si në vijim:

1. Një apo më shumë transaksione të kryera nga Jahja Lluka, që ligji kërkon të raportohen, janë kryer gjatë periudhës në fjalë,
2. Të pandehurit kanë për detyrë të raportojnë,
3. Të pandehurit e dinin apo do të duhej ta dinin se janë kryer një apo më shumë transaksione të tilla,
4. Të pandehurit me dashje nuk raportuan transaksionet e dyshimta tek autoriteti kompetent.

Elementi 1)

Sa i përket këtij elementi dhe siç u përshkrua më lart, janë konfirmuar të gjeturat e Trupit Gjykses. Sjellja e Z. Lluka, i cili me dashje ka ndarë shuma të mëdha në deponime të vogla konsektive, bie nën pjesën 3.9 b) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, dhe prandaj është dashur të raportohen në QIF siç parashihet në pjesën e njëjtë.

Elementi 2)

Pjesa 10.6 paragrafi b) i Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 parasheh përgjegjësinë e mos raportimit kur kryerësi, me detyrën për të vepruar, me dashje nuk e bën këtë. Kjo mënyrë e përgjegjësisë parashihet me Nenin 31 2) të KPK, i cili parasheh se *Vepra penale kryhet me mosveprim vetëm kur kryerësi nuk e merr veprimin të cilin ka qenë i obliguar ta kryejë*. Prandaj, duhet të ekzistojë një obligim ligjor për të pandehurin për përgjegjësinë e tij ndaj veprës penale me të cilën akuzohet.

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, secili punëtor banke, përfshirë edhe personat përgjegjës për menaxhimin dhe mbikqyrjen e punëtorëve të bankës ka detyrë të përgjithshme raportimi. Mirëpo, Rregullorja parasheh *një kontakt-person i cili do të jetë përgjegjës për ndërveprim dhe këmbim informacionesh me BPK-në dhe Qendrën, i cili u nënshtrohet detyrimeve të raportimit dhe mbajtjes së shënimeve sipas kësaj Rregulloreje*.⁶

Bazuar në interpretimin logjik të rregullores, mund të thuhet se punëtorët e bankës kanë detyrën specifike për të raportuar informatat relevante te personi i autorizuar – zyrtari kundër shpëlarjes së parave – i cili ka për detyrë të raportojë transaksionet relevante në QIF. Punëtorët e bankës janë në kontakt të drejtpërdrejtë me klientin dhe si të tillë janë në pozicion të mirë për të identifikuar operacionet financiare “të pazakonshme dhe të paarsyetueshme” dhe dyshimet. Pas kësaj, ndërlidhja me QIF është përgjegjësi ekskluzive e zyrtarit kundër shpëlarjes së parave, i cili gëzon pavarësinë dhe është i trajnuar për të përmbushur këtë detyrë specifike.

Provat dëshmuese konfirmojnë se interpretimi i tillë i kësaj dispozite ishte edhe politika e brendshme e Kasabankës sa i përket shpëlarjes së parave.

Dëshmitë e [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], si dhe [REDACTED] rrëfejnë se secili punëtor i bankës është dashur të

⁶ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2004/02 pjesa 3.16

raportojë transaksionet e dyshimta te zyrtari i autorizuar për këtë çështje. Në mënyrë të qartë, dëshmitarët deklaruan se raportimi i tillë nuk duhej t'i drejtohej apo të informohet menaxhmenti i bankës apo QIF. Provat që dalin nga dëshmitë konfirmojnë se kanë qarkulluar udhëzimet sa i përket kësaj dhe se Z. Milazim Abazi dhe Hashim Sejdiu si të tillë nuk kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetin e shpëlarjes së parave.

Elementi 3)

Dijenja mbi transaksionet e dyshimta nënkupton të qenurit të informuar mbi natyrën e palejueshme apo të dyshimtë të transaksioneve.

Rregullorja e UNMIK-ut parasheh se zyrtari kundër shpëlarjes së parave ka për detyrë të hetojë dhe të analizojë të gjitha informatat në dispozicion për qëllim të zbulimit të aktiviteteve të mundshme të shpëlarjes së parave. Punëtorët e tjerë, të cilët gjithsesi kanë për detyrë të raportojnë transaksione të dyshimta, nuk kanë detyrë analoge.

Bazuar në këtë rindërtim, të pandehurit nuk kishin detyrën autonome për të hetuar aktivitete të mundshme kundër shpëlarjes së parave, por kishte vetëm detyrën e mbikqyrjes së përgjithshme, edhe aktiviteti i Aferdita Mexhuanit.

Kjo detyrë është *in vigilando*, implicite në funksionet menaxheriale të të pandehurit, me qëllim të sigurimit se aktivitetet kryhen në mënyrën e duhur dhe shmangien e shkeljeve procedurale nga ana e stafit vartës.

Provat që dalin nga dëshmitë rrëfejnë se Milazim Abazi vërtetë kishte qenë i informuar mbi një sërë transaksionesh prej 9,000 euro të kryera që ditën e njëjtë "*në llogarinë bankare për mbrojtjen e Ramush Haradinaj*". Vetë i pandehuri ka konfirmuar dëshmitë e dhëna nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kur pranoi se ka zhvilluar një bisedë me to dikur në qershor apo korrik 2006 gjatë së cilës ai është informuar se deponime të shumëfishta janë kryer në llogarinë bankare në fjalë, në të cilën ka vepruar Z. Lluka.

Veprime të tilla të shumëfishta në llogarinë e njëjta bankare zakonisht janë të dyshimta ngase mund të kenë për qëllim t'i shmangen zbatimit të mekanizmit të raportimit në QIF. Sidoqoftë, duhet të vihet re se në rastin specifik, publiciteti i madh rreth fondit si dhe thirrja publike për kontribute, kualifikimet e jashtëzakonshme të promovuesve të fondit - këshilli i ministrisë dhe zyrtarët e qeverisë - si dhe përgjigja e madhe e popullit dhe vëmendaj e përqëndruar në fond disi janë në kundërshtim me pretendimin e epërm nagse fondi ishte e kundërta e një fondi të fshehtë për menaxhimin e aktiviteteve të paligjshme shpëlarjes së parave.

Për më tepër, natyra publike e fondit e bën plotësisht të kuptueshme aktivitetet e shumëfishta ditore. [REDAKTUAR], ekspert kundër shpëlarjes së parave dëshmoi se "*njëri nga indikatorët apo elementet që tregon se një deponim mund të jetë i dyshimt është numri ideponimeve manuale. Por, në rastin e Fondit për Mbrojtjen, ka qenë e ditur se fondi ekziston për të ofruar mbrojtjen e këtij personi. Sigurisht që njerëzit nuk kanë hezituar për të ardhur dhe për të kontribuar sa më shumë*". Përgjigja e madhe e publikut

konfirmohet nga provate dokumentuara të cilat tregojnë se disa transaksione janë kryer nga njerëz të thjeshtë.

Provat e dëshmimeve si dhe ato të dokumentuara tregojnë se edhe Z. Sejdiu ka qenë i informuar mbi numrin e jashtëzakonshëm të transaksioneve me shuma të mëdha që janë kryer në këtë llogari. [REDAKTUAR] dëshmoi se ka informuar mbikqyrësin e saj, të pandehurin, mbi dyshimet që kishte lidhur me transaksionet dhe kjo rrethanë konfirmohet nga i pandehuri tjetër, Abazi i cili pranoi se ka diskutuar me Sejdiun shqetësimet e [REDAKTUAR] lidhur me fondin, edhe pse nuk është theksuar se shqetësimet në fjalë kanë pasur të bëjnë me transaksione të dyshimta.

[REDAKTUAR] më tutje dëshmoi se mbikqyrësi i saj, Sejdiu “*më bindi se nuk ishin transaksione të dyshimta. Z. Jahja Lluka ishte personi i autorizuar për të mbledhur këto të holla nga personat që dëshironin të kontribonin*”. [REDAKTUAR] asnjëherë nuk deklaroi se mbikqyrësi e saj e parandaloi atë nga raportimi apo se e pengoi aktivitetin e saj, por vetëm tha se i pandehuri ishte i mendimit se këto transaksione nuk ishin të dyshimta.

Duke qenë kështu, kjo rrethanë e vetme përjashton përgjegjësinë penale e të akuzuarit sipas Rregullores së UNMIK-ut ngase qëllimi i të pandehurit për të fshehur transaksionet e dyshimta duhet të përjashtohet.

Së fundi, duhet të vihet re se [REDAKTUAR] nënvizoi se procedura e brendshme e Kasabankës në atë kohë ishte pjesërisht jo në pajtim me Rregulloren e UNMIK-u. Në fakt, sipas politikës së brendshme “*Nëse transaksionet kryhen brenda ditës së njëjtë, mirëpo ne si bankë kemi raportuar transaksione që ndodhën në shumën prej 10 mijë, kështu ishte rregullorja derisa ndodhi inspektimi i kryer nga QIF. Pas bastisjes, i kontrolluam edhe këto.*” [...mungon] “*pas bastisjeve, kuptuan se transaksionet që janë kryer në shumën prej 10.000 euro nuk janë regjistruar siç është paraparë me rregullore dhe pastaj që duhet ta rregullojmë këtë të metë dhe të raportojmë*”

Me këtë parasysh, Trupi Gjykses duhet të mbajë mend se në kohën e ndodhive, rregullorja sapo ka hyrë në fuqi dhe se rregulloret e brendshme janë nxjerrë në vitin 2007. Prandaj, rrethanat faktike sa i përket interpretimit të përgjithshëm të Rregullores së UNMIK-ut 2004/02 duhet të merren në konsideratë.

Elementi 4)

Së fundi, Trupi Gjykses është i mendimit se nuk ka prova që dëshmojnë se të pandehurit me dashje i janë shmangur raportimit të transaksioneve të dyshimta autoriteteve kompetente. Në fakt, provat nga dëshmitë e dhëna nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] tregojnë se të pandehurit kanë qenë të hutuar kur janë ngritur dyshimet për aktivitetet e kryera në fond.

Ky Trup Gjykses nuk është i mendimit se me dashje të pandehurit kanë lënë mënjanë informata ngase nuk është i mendimit se të pandehurit kishin për qëllim të fshehin fakte të rëndësishme QIF. Përderisa është përcaktuar se të pandehurit kanë qenë të informuar

mbi dyshimet për natyrën e disa prej transakcioneve, mund të thuhet se reagimi i tyre ndaj informatave të tilla rrëfen se nuk kishin për qëllim t'i shmangen raportimit.

Për shkak të natyrës së veçant e fondit dhe qëllimit të humanitar është vështirë të besohet se të pandehurit kishin për qëllim të fshehin një aktivitet të paligjshëm, sidomos kur kemi parasysh se "tingëllima" e zakonshme, indikacion për aktivitete të dyshimta në këtë rast nuk ka qenë e aplikueshme. Të pandehurit nuk kishin për detyrë të përcjellin informatat që morën nga zyrtari kundër shpëlarjes së parave dhe nga zyra e auditimit dhe as që kishin për detyrë menjëherë të përfshijnë QIF.

Prandaj, Trupi Gjykesues është i mendimit se të pandehurve u mungon "qëllimi dashës për të fshehur informata nga QIF", gjë që kërkohet nga dispozita e rregullores për përfshirjen e përgjegjësisë penale.

Thjesht, ata nuk ishin të mendimit se transakcionet ishin të dyshimta dhe është mendimi i kësaj gjykate se nuk kishin *mens rea* që kërkohet për përfshirjen e përgjegjësisë penale.

6) POLITIKA MBI DËNIMIN

Gjatë vendimit për dënim, Trupi Gjykesues duhet të ketë parasysh modalitete e kryerjes së krimit dhe personalitetin e të pandehurit. Dënimi duhet të jetë edhe mjet sigurimi që shërben si parandalim nga kryerja e krimeve të tjera dhe një sanksion proporcional për veprën që është kryer.

Sa u përket modaliteteve të sjelljes dhe tiparet objektive të veprave penale të kryera nga Jahja Lluca, duhet të merren në konsideratë - Sjellja e Jahja Llukës është përsëritur disa herë, sa u përket pikëve 1 dhe 2 su dhe pikës 3.

- Shumat e të hollave të pranuar nga i pandehuri dhe pastaj të deponuara në llogaritë bankare ishin mjaft të rëndësishme (dhe një gjë e tillë me urgjencë më të madhe është dashur ta shtyejë të pandehurin të raportojë transakcionet në institucionet kompetente).

- në favor të zbutjes së dënimit, Trupi Gjykesues ka parasysh personalitetin e të akuzuarit, angazhimin e tij politik si dhe rrethanën që sjelljet kriminale nuk kishin për qëllim përfitime personale.

Trupi Gjykesues është i mendimit se duke pasur parasysh rrethanat dhe parametrat e cekura më lart, dënimi me burgim prej gjashtë muajsh dhe gjoba prej Euro 6,000.00 është e duhur sa i përket veprës penale në pikën një të aktakuzës.

Dënimi për veprën penale nën pikën 2 të aktakuzës mund të caktohet me 2 muaj burgim dhe gjobën prej Euro 2,000.00.

Dënimi për veprën penale nën pikën 3 të aktakuzës mund të caktohet me 2 muaj burgim dhe gjobë prej Euro 2,000.00.

Dënimi unik për tre veprat penale është dhjetë muaj burgim dhe 10,000,00 gjobë.

Në pajtim me Nenin 43, KPPK, shqiptohet dënimi me kusht.

Duke pasur parasysh personalitetin e të akuzuarit, moshën dhe kushtet e tij, mund të konkludohet lehtë se në të ardhmen do të abstenojë nga kryerja e shkeljeve të tjera penale.

Koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim do të llogaritet në dënimin me burgim në pajtim me Nenin 391, paragrafi (1), nënparagrafi 5, KPPK.

7) SHPENZIMET

I akuzuari do të kompensojë shpenzimet e procedurës në pajtim me Nenin 102, paragrafi (1), KPPK me përjashtim të shpenzimeve për interpretim dhe përkthim. Gjykata do të sjellë një vendim të veçantë me marrjen e informatave në fjalënë pajtim me Nenin 100, paragrafi (2), KPPK.

Prishtinë, 12 shkurt 2010

Kryetari i Trupit Gjykses

Francesco Florit

Anëtar i Trupit Gjykses

Mehidi Dehari

Anëtar i Trupit Gjykses

Ferdinando Buatier de Mongeot

Proces-mbajtës

Francesco Caruso

Bashkëpunëtor Profesional nga EULEX

Këshillë juridike

Në pajtim me Nenin 400, para. 1) KPPK, ankesë ndaj këtij vendimi deklarohet menjëherë dhe jo më vonë se 8 ditë nga data e shpalljes publike të këtij aktgjykimi. Në pajtim me Nenin 398, KPPK, para. 1), personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë ndaj aktgjykimit të nxjerrë në shkallën e parë brenda 15 ditësh nga data e pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi.